



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:093984  
Datë: 10.01.2025  
Numri i dokumentit: 06696394

P.nr.253/24

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerinda Laiq, në çështjen penale, kundër të pandehurit M.I, me vendbanim në fshatin....., Komuna e Deçanit, i akuzuar për shkak të veprës penale “*Sulmi*” nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-së, duke vepruar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2444/2023, të datës 22.03.2024, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 06.01.2025, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, i dëmtuari Sh.B, i pandehuri M.I., si dhe mbrojtësi i të pandehurit, av. Blerim Ademaj me datë 09.01.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 10.01.2025, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**M.I**, i atësisë I. dhe amësisë T., e vajzërisë ..... i lindur me datë ..... në Pejë, me vendbanim në fshatin ....., rr. “.....”, nr....., Komuna e Deçanit, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion ....., i identifikuar ne baze të letërnjoftimit me numër personal ....., i lëshuar nga MPB, Republika e Kosovës, posedon nr. te tel. .... dhe ....., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i **paraburgosur në kohën e kryerjes se veprës penale në fjalë.**

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

*Me datë 04.11.2023, rreth orës 17:45min, në rr. “Shpëtim Bojku” Komuna e Pejës, konkretisht në Qendrën e Paraburgimit në Pejë (krahu C, salla e ushqimit), me dashje përdorë forcën ndaj të dëmtuarit Sh.B, në atë mënyrë që, pas një fjalosje paraprake në mes të dëmtuarit dhe të pandehurit, ku ky i fundit i ishte drejtuar të dëmtuarit me fjalët se “pse je duke dëgjuar lexim të Kuranit, se sa të dalim nga dhomat kur të shkojmë për darkë kom me ta treguar qejfin”, ashtu që, me të përfunduar darkën në sallën e ushqimeve, i pandehuri fillimisht fyen të dëmtuarin me fjalë e më pas e godet me një tas të konservës metalike në pjesën e ballit mbi syrin e djathtë,*

- Me çka ka kryer veprë penale "*Sulmi*" nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 1, 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 46, 69, 70, dhe 184 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe neneve 240, 241 paragrafi 1, 242 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 24, 242 paragrafi 6, 364, 449, 450, 452 paragrafi 1, 460 dhe 462 paragrafi 2 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

## G J Y K O N

- I.** Me **DËNIM ME BURGIM**, në kohëzgjatje prej njëqindnjëzetë (120) ditësh, i cili dënim do të ekzekutohet, menjëherë pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** I pandehuri obligohet që gjykatës ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor në shumën prej tridhjetë (30) euro, dhe shumën prej njëzetë (20) euro në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit.
- III.** I dëmtuari Sh.B, me vendbanim në fshatin .....Komuna e Istogut, gjatë shqyrtimit fillestar shprehimisht ka hequr dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, me datë 22.03.2024 ka ngritur aktakuzë nën shenjen PP/II nr. 2444/2023, ndaj të pandehurit M.I, për shkak të veprës penale "*Sulmi*" nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale konform dispozitës së nenit 240 të KPPRK-së, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 06.01.2025, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, të dëmtuarit Sh.B, të pandehurit M.I, si dhe mbrojtësit të të pandehurit M.I, av. Blerim Ademaj nga Peja, i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të pandehurit gjykata i ka komunikuar të drejtat dhe detyrimet e tij ligjore konform nenit 241 paragrafi 1 të KPPRK-së, pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit dhe pasi që gjykata është bindur së i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, të pandehurit i është dhënë mundësia që të deklarohej mbi fajësinë, por paraprakisht i janë shpjeguar kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ashtu që i njëjti me vullnet të plotë dhe pa kurrfarë presioni ka deklaruar së pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, respektivisht për veprën penale "*Sulmi*" nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës, pa asnjë ndryshim dhe se i njëjti është i penduar, i vie keq për atë se çfarë ka ndodhur, dhe së të dëmtuarit i kërkon falje. Gjykata gjatë seancës së shqyrtimit fillestar ka marrë mendimin e palëve në procedurë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me ç'rast Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar së: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit*, ngjashëm është deklaruar edhe i dëmtuari Sh.B i cili deklaroi së: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit*. Më pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit të lartcekur është pajtuar edhe mbrojtësi i tij, av.

Blerim Ademaj i cili ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, i njëjti është bere në konsultim të mjaftueshëm me mua si mbrojtës dhe kërkoj nga gjykata që ti aprovohet.*

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitat ligjore të nenit 242 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit dhe pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Raporti i oficerit R.P. KPS 7062 i datës 06.11.2023; Forma për raportimin e incidentit nga Qendra e Paraburgimit Pejë e dt. 04.11.2023; Deklarata e të dëmtuarit Sh.B e dhënë në St. Policor në Pejë me dt. 06.11.2023; Deklarata e të pandehurit M.I, e dhënë në Qendrën e Paraburgimit në Pejë me dt 05.11.2023; Foto-dokumentacioni i shkresave të lëndës, ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 paragrafi 6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.*

Sa i përket caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar së: *siç edhe e theksova me lartë, në rastin e matjes se dënimit i propozoj gjykatës që si rrethanë rënduese të marrë parasysh dënimet e mëparshme të të pandehurit ndërsa si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.*

I dëmtuari Sh.B, ka deklaruar së: *me të pandehurin jemi pajtuar, unë i'a kam falur veprimet të cilat i ka bërë, unë shpresoj që me nuk do të ndodh një gjë e tillë, nuk kam çfarë të shtojë më shumë, nuk dëshiroj të paraqes kërkesë pasurore juridike.*

Mbrojtësi i të pandehurit M.I, av. Blerim Ademaj, ka deklaruar së: *lidhur me matjen e dënimit i propozoj gjykatës që si rrethanë posaçërisht lehtësuese të mirret pranimi i fajësisë, pendimi, kërkim falja, premtimi që në të ardhmen nuk do të përsërisë veprë penale dhe i propozoj gjykatës që ndaj të njëjtit të shqiptohet minimumi i dënimit të paraparë.*

I pandehuri M.I ka deklaruar së: *i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, i kam kërkuar falje të dëmtuarit, jam penduar për veprën penale që e kam kryer.*

Prandaj me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Sulmi” nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjyqtarja e vetme gjykuese në bazë të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë, i ka kërkuar falje të dëmtuarit shprehimisht në seancë, ka shprehur keqardhje dhe është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer, ndërkaq si rrethana rënduese gjykata mori vendin e kryerjes së veprës penale e që është brenda Qendrës së Paraburgimit, pastaj faktin se i njëjti është i dënuar sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjë P.nr.242/22, të dt.16.12.2023, i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 07.02.2024, për shkak të veprës penale “*Vjedhja*” nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, me dënim me gjobë në lartësi prej 300 (treqind) Euro si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, të cilat dënime kushtëzohen, nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej dy (2) viteve, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, po ashtu i njëjti është dënuar edhe sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti i Krimeve të Rënda, nën shenjë P.nr.184/2014, të datës 04.06.2014, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 07.02.2024, për shkak të dymbëdhjetë (12) veprave penale “*Vjedhja grabitqare*” nga neni 254 paragrafi 1 të KPRK-së, me dënim unik me burgim prej katër (4) vite. Poashtu sa i përket sjelljeve dhe personalitetit të pandehurit në të kaluarën gjykata ka gjetur se i njëjti është i dënuar edhe me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Pejës-Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjë P.nr.1048/22 të datës 07.11.2024, i cili është i dënuar me dënim me burgim me gjobë në shumën prej 700 euro, për veprën penale “*Posedim i paautorizuar i narkotikëve apo substancave psikotrope apo analoge*”, nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, mirëpo këtë aktgjykim nuk e mori në vlerësim në kundër të rrethanave rënduese pasi që i njëjti ende nuk figuron të jetë bërë i plotfuqishëm.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbejë për arritjen e qëllimit të tij e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit me burgim si në pikën I të dispozitave të këtij aktgjykimi, gjykata e mori duke u bazuar në nenin 184 par. 1 të KPRK-së, e lidhur me nenin 42 të KPRK-së.

Sipas nenit 184 par.1 të KPRK-së, dënueshmëria për këtë vepër penale sipas ligjvënësit është përcaktuar me: “*Kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit*”, andaj gjykata për të njëjtin ka shqiptuar dënim me burgim prej njëqindnjëzetë (120) ditësh sipas nenit 42 të KPRK-së. Përcaktimi i dënimit me burgim prej 120 ditësh, u bë duke e filluar matjen e dënimit nga pikënisja e dënimit, e që është 6 muaj e gjykata duke marrë në vlerësim rrethanat lehtësuese si dhe rrethanat rënduese të cekura si më

lartë, gjykata ka shqiptuar dënimin si në pikën e parë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, përmes të cilit vlerëson se do të arrihet rehabilitimi i të pandehurit se dhe do të ndikoj në rehabilitimin dhe pengimi e të njëjtit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 449 paragrafi 1 dhe 2, dhe nën paragrafi 2.6, nenit 450 dhe 452 paragrafi 1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi lidhur me taksën për programin e kompensimit të viktimave, është marr konform nenit 36 paragrafi 1, 2, 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

I dëmtuari Sh.B, me vendbanim në fshatin ....., Komuna e Istogut, gjatë shqyrtimit fillestar shprehimisht ka hequr dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike, respektivisht nuk ka parashtruar një kërkesë të tillë, andaj mbi këtë arsye gjykata, e në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 458, 459 dhe 460 të KPPRK-së, të dëmtuarin nuk e ka udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Andaj, nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr. 253/24, me datë 10.01.2025.**

**Zyrtarja ligjore**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**

**Blerinda Laiq**

\_\_\_\_\_  
**Blerta KERMENDI**

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e pakënaqur brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa parashtrohet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.